




Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna Skenderaj
Opština Skenderaj
Municipality of Skenderaj

Ekstrakt nga procesverbali i mbledhjes së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, i mbajtur më 28 shkurt 2024.

Të pranishëm në mbledhje:

Kryetari i Komunës, Fadil Nura, Qazim Miftari (Policia e Kosovës), Mihane Bekteshi, Agron Kajtazi, FSK, Gordana Tomic, Imer Salihu, Kastriot Duraku, Valon Haliti, Ibrahim Hoti, Dejan Tomic

Në këtë mbledhje janë diskutuar këto pika:

- Miratimi i rendit të ditës
- Shqyrtimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
- Raporti i Punës për vitin 2023
- Miratimi i Planit të Punës për vitin 2024
- Diskutim rreth çështjeve të sigurisë
- Diskutim rreth dukurive të përdorimit të substancave narkotike
- Të ndryshme

Kryetari Nura: Përshëndetje të gjithëve. Konstatoj se kemi kuorum për mbajtjen të mbledhjes. Besoj materialin e keni marrë me kohë. E qes në votim këtë rend të ditës. Pra me votën e të gjithë anëtarëve të pranishëm, vazhdojmë mbledhjen me këtë rend të ditës.

Kalojmë te shqyrtimi i proces verbalit nga mbledhja e kaluar. Keni dicka. Urdhëro Agron.

Agron Kajtazi: Faleminderit kryetar. Kam një vërejtje te përmbajtja, do të ishte mirë të ketë më shumë kujdes procesmbajtësi, sepse po humb kuptimi i dikustimeve nëse nuk përfshihet saktë ajo që diskutohet.

Kryetari Nura: Faleminderit, dikush tjetër. Atëherë me vërejtjen për procesverbal, kalohet edhe kjo pikë.

Vazhdojmë me pikën tjetër Rarporti i Punës për vitin 2023 i KKSb-së. Si kryesues i këtij organi, do të paraqes në pika të shkurta aktivitetin dhe punën që kemi bërë i këshill. Kemi mbajtur gjatë vitit të kaluar gjithsej 6 mbledhje, ashtu sic është e përcaktuar edhe në aspektin ligjor. Kemi arrit të përmbushim objektivat si KKSb, të nxjerrim rekomandime dhe t'i adresojme çështjet me të

cilat jemi përballur. Vlerësoj se sa i përket situatës së sigurisë edhe vitit 2023 ka qenë vit i mirë dhe i qetë, siguria vazhdon të jetë në nivel të kënaqshëm, kjo falë bashkëpunimit të mirë me qytetarë, Policinë e Kosovës dhe të gjitha organet tjera. Do të vazhdojmë edhe këtë vit të jemi të përkushtuar plotësisht të ofrojmë siguri dhe situatë të mirë për të gjithë qytetarët e komunës së Skenderajt. Nuk do të kisha zgjat më shumë, e keni edhe në formën e shkruar raportin e punës së KKS-së, nëse nuk keni ndonjë çështje për diskutim, e qes në votim. Kush jeni për. Faleminderit, konstatoj se kalon edhe pika e raportit të punës për vitin e kaluar. Vazhdojmë me pikën tjetër, Plani i Punës për vitin 2024.

Është një dokument mbi bazën e të cilit do të vazhdojë aktivitetin e vet KKS, pra është kalendari i takimeve gjatë këtij viti, objektivat, aktivitetet që do t'i zhvillojmë. E qes në diskutim këtë pikë.

Agron Kajtazi: Muaji gusht është muaji i pushimve, a do të ishte më mirë që mbledhja e gushtit sic është në kalendar të vendoset në korrik?

Kryetari Nura: Edhe në vitin 2023 mbledhja e KKS-së ka qenë në muajin gusht dhe e kemi mbajtur me prani të të gjithë anëtarëve. Do të ishte më rrezik pjesëmarrja në muajin korrik sepse atë kohë fillojnë njerëzit pushimet. Nëse pajtoheni e lëmë kështu, pra që mbledhja e gushtit të mbetet e pandryshuar, pra në gusht. Faleminderit! Kalojmë të pika tjetër rreth çështjeve të sigurisë. Urdhëro Qazim.

Qazim Mifati (Policia e Kosovës): Faleminderit kryetar! Sa i përket sigurisë, konstatoj se situata është e qetë dhe shumë e mirë. Nuk kemi pas ndonjë shqetësim në këtë aspekt. Policia e Kosovës është e përkushtuar që të kontribuojë në ruajtjen e qetësisë dhe sigurisë publike. Një falënderim për kryetarin Nura për bashkëpunimin që kemi pas dhe që vazhdojmë ta kemi. Na ka ndihmuar me veturë për policinë e Kosovës e cila ka kontribuar në aktivitetin e parandalimit të veprave të ndryshme. Trendi i krimit është në rënie. Ndihma juaj dhe aktiviteti policor kanë ndikuar të kemi më pak raste. Një kërkesë e kemi, sa u parkët fshatrave të vendosen edhe në fshatra kamerat e sigurisë. Ne kemi bashkëpunim dhe komunikim të vazhdueshëm edhe Inspektoratin e Komunës.

Kryetari Nura: Faleminderit, megjithatë kemi disa vërejtje sa i përket aktivitetit dhe bashkëpunimit tonë të ndërsjell, për cka fjalën ia kaloj drejtorit të Inspektionit. Urdhëro drejtor.

Valon Haiti, drejtor i Inspektionit: Faleminderit kryetar. Komunikimin me policinë e Kosovës e kemi të vazhdueshëm. Megjithatë, në disa raste të vendosjes së shiritave pranë objekteve që po ndërtohen, ka largim të shiritave, cka paraqet vepër penale. Mendoj se për këto raste nuk ka nevojë për raport nga ana e Insketoreve për policinë e Kosovës. Policia duhet të mbikëqyrë dhe të ndërmarrë masat e duhura ndaj këtyre rasteve.

Qazim Miftari (Policia e Kosovës): Pajtohem plotësisht me këtë konstatim. Besoj se më nuk do të përseriten këto raste. Policia e Kosovës do të jetë në krye të detyrës dhe do të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore ndaj këtyre dukurive.

Kryetari Nura: A janë duke funksionuar kamerat e sigurisë?

Qazim Miftari (Policia e Kosovës): Një nga to te fusha ndihmëse ka qenë jashtë funksionit, mirëpo është intervenuar dhe është rregulluar defekti, kamera tani është në funksion.

Ibrahim Hoti (Këshilli i Bashkësisë Islame): Ka informata për hapje të mezideve* në rrugën 17 Shkurti, e cila është duke funksionuar pa leje të KBI-së. KBI është kundër kësaj, sepse në qytet kemi xhaminë ku mund të kryhen ceremonitë e faljeve të namazeve dhe xhumaja.

Kryetari Nura: Ne do të koordinohemi me KBI-në për këtë rast dhe të tillat. Të na dërgoni njoftimin dhe vendimin që është pa lejen e KBI-së, në mënyrë që si Komunë në bashkëpunim me organet tjera të ndërmarrim veprimet e duhura.

Qazim Miftari (Policia e Kosovës): Përveç këtyre që u potencuan, aty zhvillohen edhe veprime tjera të dyshimta.

Ibrahim Hoti: Ky grup i këtij sektit tefkir* është jashtë rregullave të Bashkësisë Islame. Këta njerëz nuk falen pas hoxhës qysh është e përcaktuar me rregulla fetare islame tradicionale. I kanë rregullat e veta krejt të ndryshme nga ato që janë të njohura tradicionalisht.

Kryetari Nura: Faleminderit për diskutime për këtë çështje, do të kemi koordinim për veprime të përbashkëta ndaj kësaj çështjeje. Kalojmë te pika diskutim rreth dukurive të përdorimit të substancave narkotike. Kemi informata për raste të përdorimit të substancave narkotike nga të rinjtë në shkolla. Është një zinxhir ky ku të gjithë kemi përgjegjësi.

Kastriot Duraku, drejtor i Arsimit: Kemi mbajtur takim me drejtorë të shkollave nga të cilët kemi kërkuar angazhim të shtuar nga të gjithë, në mënyrë që të eliminojmë këtë dukuri. Si drejtori kemi realizuar disa aktivitete kryesisht informuese me nxënës, nëpërmjet ligjëratave dhe aktiviteteve tjera edukuese, të cilat do t'i vazhdojmë edhe në të ardhmen.

Qazim Miftari (Policia e Kosovës): Bashkëpunimi me ne nuk do të mungojë. Edhe policia e Kosovës ka zhvilluar disa aktivitete në bashkëpunim me Komunën e Skenderajt, rreth vetëdijesimit të të rinjve dhe nxënësve për dukuritë negative të përdorimit të substancave narkotike në shkolla. Kemi identifikuar raste të përdorimit të drogave dhe kemi ndërmarrë veprime.

Kryetari Nura: Në këtë çështje edhe KBI do të mund të ndihmonte me ndonjë ligjëratë në xhami, në mënyrë që të kotribuohet në vetëdijesimin e të rinjve për dukuritë negative.

Ibrahim Hoti (KBI): Ne në xhami organoizojmë ligjëratat të ndryshme me tema edhe të kësaj natyre.
Kryetari Nura: Faleminderit shumë për diskutime. Do të vazhdojmë angazhimin tonë të

përbashkët që t'i adresojmë edhe këto raste dhe të mos këtë të tilla. Kalojmë te pika të ndryshme.
Urdhëro Dejan

Dejan Tomic: Kem një kërkesë, mëditjet nga takimet e KKSB-së, nuk i kam marrë, nuk e di ku është problemi.

Kryetari Nura: Do të merrem edhe më këtë çështje, do të konsultohem me Zyrën për Menaxhimin e Burimeve Njerëzore dhe do të shohim ku qendron problemi.

Nëse nuk keni dicka tjetër, po e përmbyll këtë takim. Shihemi në mbledhjen e ardhshme.

Faleminderit dhe mirë u pafshim!

Procesmbajtësi

Jeton Rushiti

